



Pranuar / Dorezuar Prilbjenoi/Prudato Received/Delivry	22-04	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtylla Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIPMESHOK	2339/2022		113	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.666/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arbën Mehmeti kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.666/2021 të datës 19.07.2021 e parashtruar nga ankuesja me adrese

kundër organit të punësimit Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22/04/2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.666/2021 e datës 19.07.2021 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja është e sistemuar në vendin e punës "Nëpunëse e lartë për koordinim teknik, informim, marrëdhënie me publikun" në Zyrën e Udhëheqësit Ekzekutiv, sipas akt emërimit të datës 09.03.2018, ankuesja me datë 19.07.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3786/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor për pengim në kryerjen e detyrave të punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar lëndën e ankuses ka konstatuar se ankuesja disa herë nëpërmjet e-mail-it zyrtar ka kërkuar që të kontaktoj me udhëheqësin e drejtpërdrejtë të saj për mos pengimin në detyrat e saj të punës nëpërmjet e-mail-it zyrtarë atë me e-mail-in e datës: 16.07.2021, 06.07.2021, 10.06.2021, 24.05.2021, 07.04.2021 dhe atë të datës 31.03.2021 dhe ankuesja në ankesën e saj të datës 19.07.2021 të parashtruar në Këshill ka pretenduar se udhëheqësi i drejt për drejtë i saj asnjëherë nuk është përgjigjur dhe se nuk e ka ftuar asnjëherë në takim për të diskutuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.09.2021 përmes Njoftimit me numër protokoll 4507/2021, ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.666/2021 të datës 19.07.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjtën mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 16.03.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2382/21, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e datës 06.09.2021 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.666/2021 të datës 19.07.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.07.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Këshilli me datën 03.08.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokoll 4058/2021 nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore së bashku me provat e lëndës faqe 1/21.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 19.07.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës i pozitës "Asistente Ekzekutive-nëpunës i lartë për koordinim teknik, informim dhe marrëdhënie me publikun"; Rregullorja me Nr.02/2010 Mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore; E-mail-at e datave 16.07.2021; 06.07.2021; 10.06.2021; 24.05.2021; 07.04.2021; 31.03.2021; Konkursi për vendin e punës "Asistente Ekzekutive"; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për ankuesen i datës 09.03.2018; Formulari i vlerësimit i datës 31.12.2019, 27.04.2021; e-mail i datave 14.07.2021, 02.08.2021; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit i datës 03.08.2021 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Njoftimi i datës 06.09.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesen Aktgjykimi me numër A.nr.2382/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative si dhe Provat shtesë të ankueses së datës 21.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe pas analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se lënda e ankueses është ***e pa bazuar, sepse:***

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 09.03.2018, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Nëpunëse e lartë për koordinim teknik, informim, marrëdhënie me publikun" në Zyrën e Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. E njëjta me datë 31.03.2021 nëpërmjet e-mail-it ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i saj i Drejtpërdrejtë, për mos delegim të detyrave zyrtare të saj tek kolegët e tjerë pasi që ka aftësi dhe përvojë që ti kryej ato, me datë 06.04.2021 udhëheqësi i drejt për drejt i ankueses e njofton se sipas Vendimit me numër 01/05 pika 6 të Qeverisë së të Republikës së Kosovës, në punë duhet të paraqitet vetëm stafi esencial andaj edhe deri në ndryshimin e këtij vendimi ju vazhdoni ti kryeni detyrat nga shtëpia, pastaj ankuesja me datë 07.04.2021 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë përsëri kërkon nga udhëheqësi i saj që mos ti delegoj detyrat tek zyrtarët tjerë të KKTK për ti kryer detyrat sepse ka aftësi dhe përvojë që ti kryej ato, kështu për mos pengim të detyrave të punës ankuesja vazhdon të bëjë e-maila përsëri tek Udhëheqësi i saj edhe me datat 24.05.2021,

10.06.2021, 06.07.2021 si dhe me e-mail-in e datës 16.07.2021, udhëheqësi i saj me datë 14.07.2021 i përgjigjet e-mail-it të ankueses të datës 14.07.2021 po ashtu edhe me e-mail të datës 02.08.2021 me të cilën kërkon nga ankuesja që ti kryej detyrat e saj të punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 18 paragrafit 1 ku është përcaktuar se: *“Çdo institucion siguron një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune për mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe të dinjitetit të zyrtarit”*, e që rrjedhimisht udhëheqësi i drejt për drejtë i ankueses në e-mailin e datës 02.08.2021 ia ka bërë me dije ankueses se ka plotësuar të gjitha kushtet e punës mirëpo Kolegji ka konstatuar po ashtu se udhëheqësi duhet që të diskutoj me nëpunësen për tejkalimin e problemeve të cilat mund të hasin gjatë ushtrimit të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës duke u bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës ka konstatuar se edhe ankuesja dhe udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë lidhur me çështjen kontestuese duhet që ta shqyrtojnë bashkarish çështjen paraprake dhe po ashtu Kolegji ka gjetur se pretendimet e ankueses në ankesën e datës 19.07.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë kundërthënëse pasi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses iu është përgjigjur në e-mail-at të cilat i ka dërguar ankuesja kur e ka pa të nevojshme një gjë të tillë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.666/2021, datë 22/04/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankueses
- ❖ Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- ❖ Udhëheqëses së Personelit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimisë Kulturore dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

